3	Numri i pamjaftueshëm i inspektimeve mbi vendbanimet ilegale	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar Nuk menaxhohet	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Rritja e cilësisë dhe numrit të inspektimeve mbi vendbanimet ilegale	Orgz Punë Proc
4	Kanalet e dobëta për marrjen e reagimeve nga aktoret e jashtëm	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar Nuk menaxhohet	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Forcimi i kanalave për të marrë reagime nga aktoret e jashtëm	Orgz Punë Proc
5	Mungesa e profesionalizmit të inspektoreve	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar Nuk menaxhohet	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Ngritja e profesionalizmit të Inspektoreve	Orgz Punë Proc

FUSHAT E RREZIKUT;Edukimi dhe kultura

Përkufizimi i rrezikut:Funksioni i edukimit nuk është efikas dhe i mungon kontrolli

Nr	FAKTORET E RREZIKUT	BURIMET E FAKTOREVE TË RREZIKUT	MASA EKSISTUESE ,KONTROLLET EVENDOSURA	ANALIZA E RREZIKUT	VLERËSIMI I PËRGJITHSHEM I RREZIKUT	MASAT E SUGJERUARA PËR RREZIK	BURIMET E MASES SE RRRZIKUT
1	Rregullimi i mirëmbajtjes se infrastrukturës shkollore nuk është rifreskuar ne përputhje me nevojat	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar Nuk menaxhohet	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Zhvillimi i procedurave standarte per rindërtim te shkollave ne kritere te qarta	Orgz Punë Proc
2	Siguria e dobët fizike e shkollave	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar Nuk menaxhohet Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Përmirësimi i sigurisë publike nepr shkolla	Orgz Punë Proc
3	Punëtoret teknik nuk janë të angazhuar ne mirëmbajtjen e ndërtesave	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar Nuk menaxhohet	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Angazhimi i punetoreve teknik ne mirëmbajtjen e ndërtesave	Orgz Punë Proc
4	Mungesa e bashkëpunimit te OJQ-ve me partneret e biznesit	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar Nuk menaxhohet	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Rikonstruimi i bashkëpunimit me OJQ-të	Orgz Punë Proc
5	Rekrutimi i stafit ne sektorin e edukimit	Organizative Punetoret	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e	Probabiliteti Ndikimi	Rekrutimi i stafit te duhur arsimor ,kujdes i	Orgz Punë

	nuyk është efikas	Proceset		menaxhuar Nuk menaxhohet	Vls i përgjith	veqant ne përzgjedhjen e stafit	Proc
6	Poltika ne sektorin e edukimit është e paefektshme	Organizative Punetoret Proceset	N/A			Miratimi një politike afatmesme dhe afatgjate ne sektorin e edukimit	Orgz Punë Proc

FUSHAT E RREZIKUT;Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Përkufizimi i rrezikut: Shëndetësia dhe mirëqenia sociale nuk janë efikase dhe i mungon kontrolli

Nr	FAKTORET E RREZIKUT	BURIMET E FAKTOREVE TË RREZIKUT	MASA EKSISTUESE ,KONTROLLET EVENDOSURA	ANALIZA E RREZIKUT	VLERËSIMI I PËRGJITHSHEM I RREZIKUT	MASAT E SUGJERUARA PËR RREZIK	BURIMET E MASES SE RRRZIKUT
1	Infeksionet nuk identifikohen me kohë	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Identifikimi në kohë i infeksioneve, përmirësimi i vetëdijes dhe vaksinat e obligueshme ,modernizimi i punës ne qerdhe	Orgz Punë Proc
2	Mungs e stafirt profesional që punon ne QKMF	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Sigurimi i stafit profesionale që punon ne QKMF	Orgz Punë Proc
3	BUXHETI NUK ËSHTË RRITUR NË BAZË TË DËSHMIVE OBJEKTIVE	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Rritja e buxhetit ne përputhje me rrethanat ,duke u bazuar ne dëshmi objektive	Orgz Punë Proc
4	Strehimoret nuk janë të përshtatshme	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Përmirësimi i srhimoreve për te moshuarit	Orgz Punë Proc

5	Planifikimi i barnave nuk është plotësisht efikas	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Përmirësimi i planifikimit përkates dhe modernizimi i politikave	Orgz Punë Proc

FUSHAT E RREZIKUT;Bujqësia dhe zhvillimi rural

Përkufizimi i rrezikut:Bujqësia dhe zhvillimi rural nuk janë efikase dhe i mungon kontrolli.

Nr.	FAKTORET E	BURIMET E	MASA	ANALIZA E	VLERËSIMI I	MASAT E	BURIMET
-----	------------	-----------	------	-----------	-------------	---------	---------

	RREZIKUT	FAKTOREVE TË RREZIKUT	EKSISTUESE ,KONTROLLET EVENDOSURA	RREZIKUT	PËRGJITHSHEM I RREZIKUT	SUGJERUARA PËR RREZIK	E MASES SE RRRZIKUT
1.	Mungesa e kriterëve dhe procedurave të qarta për ndarjen e subvencioneve	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Sigurimi i ndarjes së subvencioneve është bërë në bazë të një kuadri strikt të kriterëve ,me transparencë të zgjeruar	Orgz Punë Proc
2	Ka mungesë të inspektoreve pyjor	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Te sigurohet që numri i inspektoreve në sektorin e pyjeve mbulon edhe nevojat aktuale të komunës	Orgz Punë Proc
3	Mungesa e trajnimeve profesionale të inspektoreve	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Rritja e trajnimeve të ndryshme profesionale për inspektorin	Orgz Punë Proc
4	Mungesa e vetëdijes për rreziqet specifike	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Rritja e ndergjëhgjsimit të qytetareve në lidhje me menaxhimin e rreziqeve specifike	Orgz Punë Proc
5	Mungesa e kompetencave mes aktoreve kyq që lidhen me këtë	Organizative Punetoret Proceset	N/A	Menaxhuar Pjesërisht e menaxhuar	Probabiliteti Ndikimi Vls i përgjith	Nepermjet paraqitjes së mendimeve pjesëmarrjes në grupe punuese	Orgz Punë Proc

	funktion						
--	----------	--	--	--	--	--	--



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. _____ 2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e punës së Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 26. 05. 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje është kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e Komunës, znj. Marqe Selamni, komandanti i policisë, z. Ragip Bytyqi, drejtorë të drejtorive, media lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi z. Valmir Bacaj me autorizim të kryesuesi t z. Fadil Gashi, I cili mungonte .

z. Bacaj përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe konstatoi që prezent janë 24 anëtarë të kuvendit duke pritur që të I bashkohet kësaj séance edhe Kushtrim Haliti dhe Besiana Gashi. Z. Bacaj tha se janë 6 pika të rendit të ditës shto këtu edhe një pikë nga drejtoria FEZH-Raporti I dëgjimeve publike në lidhje me draft buxhetin.

Në lidhje me rendin e ditës fjalën e mori z. Zafer Gashi.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje të gjithëve. Në lidhje me rendin e ditës e shoh që nuk ajnë future kërkesat që grupi kuvendar I LVV I ka dërguar me datën 17.05. 2023 për interpelancë. Kërkojmë sqarime pse nuk janë në rend të ditës këto kërkesa?

z. Valmir Bacaj, kryesues: Ne rendin e ditës e kemi pranuar me datën 15. 05. 2023 ndërsa kërkesat kanë ardhur me datën 17 dmth kanë ardhur pasi që është shpërnda njoftimi prandaj këto kërkesa për interpelanca do të mbesin për mbledhjen tjetër. Po ashtu një kërkesë tjetër ka ardhur gabim , ka ardhur nga qendra e LVV, znj, Mulaj. Do të duhej të ishte nga grupi kuvendar I LVV e jo nga qendra.

z. Esat Raci: Përshëndetje të gjithëve. Pasi që po mungon sot kryesuesi,. Ai e din që insistimi im ka qenë I vazhdueshëm që të raportohet nga komisioni për fabrikën e çimentos. Ju lutem që të ja thoni kryesuesit këtë.

Rendi I Ditës me pikën shtesë vihet në votim dhe me shumicë votash MIRATIOHET.

Pika 1 e rendit të Ditës: Arsyetimi I mungesave

Konstatohet që mungon kryesuesi pasi që është jashtë vendit si dhe Besiana Gashi e cila do të mbërrij së shpejti.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

z. Zafer Gashi, kishte vërejtje në lidhje me datën që shkruan në fillim të procesit dhe që është gabim. Po ashtu ai tha që me udhëzimin e kryesuesit që të zvogëlohet shkrimi I procesverbalit. Por këtu në ëproces nuk është cekur për dokumentet që kryesuesi ka thënë se janë pëlqime të dhëna nga Ministria. Mirë është që ato reshta të vendosen në proces.

z. Valmir Bacaj, kryesues: Tek pjesa e parë ke të drejt është një gabim teknik ndërsa për pjesën tjetër jo sepse është propozim I kryesuesit që të zvogëlohet procesi I shkruar.

Me dy abstenim , asnjë kundër u miratua Procesverbali

Pika 3 e Rendit të Ditës:Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi z. Bacaj tha se janë dy rekomandime. Një është në rend të ditës ndërsa tjetra është : Banorët e fshatit Shtupel, lagja Bakaj, rruga “Fadil Zhabota” kërkojnë që të shtohet edhe një pjesë e rrugës për emërtim .Ndërsa rekomandimi I KPF është që kërkesa për ndryshim të emrit të rrugës të dërgohet për shqyrtim tek komisioni për shqyrtim dhe emërtim të rrugëve.

z. Esat Raci: Ne si grup kuvendar të dy rekomandimet e KPF-së I mbështesim

z. Zafer Gashi: Vitin e kaluar ka qenë kërkesë e gr. Kuvendar të LVV që në bursa të përfshihen edhe nxënësit e dalluar përveç studentëve. Kërkojmë që kjo të realizohet në këtë vit.

z. Bacaj tha se buxheti për këtë vit është aprovuar, vitin tjetër me siguri që do të futen pasi që është edhe premtim I kryetarit.

Me shumicë të votave, rekomandimet e KPF-së u MIRATUA

z. Zafer Gashi për rekomandimet tha se nuk I vjen turp që ta përsëris premtimin e kryetarit të komunës që para 7 muajve , I cili kishte premtuar që për z. Sokol Gashi ta realizoj kërkesën e tij për ndihmë. Nëse e kanë kryer ju falënderoj por deri para pak ditësh nuk ka qenë.

Kryesuesi tha se kjo le të kaloj tek pyetje e përgjigje.

Pika 4 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit të DKA për ndarjen e bursave për studentët, formimi I komisionit për ndarjen e bursave.

Kryesuesi tha se në këtë pikë do të marrin dy vendime . 1. Për vlerën e bursës dhe 2. Formimin e komisionit. Janë gjithsej 60 bursa që do të ndahen sipas kërkesës së DKA dhe vlera e një burse është 50 euro, tha z. Bacaj.

z. Asdren Ramadani: Përshëndetje. Propozimi im në KPF ishte që të ngritet bursa nga 50 euro në 70 euro. Arsye ishte sepse kanë lëvizur çmimet në gjithçka, të paktën ti përkrahim pak më shumë.

z. Valmir Bacaj, kryesues tha se askush nuk është kundër kësaj ngritje por është aprovuar në kuvend një rregullore prandaj çdo kërkesë që ka implikacione buxhetore duhet parë situatën financiare. Vitin e kaluar kemi pasur 40 përfitues ndërsa tani kemi 60.

z. Arben Limanaj: Edhe ne si grup e mbështesim propozimin e DKA për ndarjen e bursave. Propozimi I z. Ramadani është I mirë nëse drejtorja e DKA ka mundësi buxhetore dhe na thotë që janë mundësitë.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Propozimin e Asdrenit e kam përkrahur edhe unë në KPF por kam thënë që të shikohen mundësitë financiare. Nëse jo këtë vit , vitin tjetër të marrim vendim që të rritet vlera e bursës.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Përshëndetje të gjithëve. Rekomandimi I KPF-së është Brenda mundësive buxhetore. Në pikën tjetër e kemi KAB, ku është future si mundësi që të rriten bursat por për vitin e ardhshëm si dhe përfshirjen edhe të nxënësve si përfitues të bursave , në këtë kornizë afatmesme buxhetore.

z. Asdren Ramadani e morri përsëri fjalën duke thënë se të paktën të hiqet ndonjë projekt dhe të përkrahen studentët tanë.

z. Esat Raci: Si Grup Kuvendar e përkrahim plotësisht kërkesën e DKA-së. Sa I përket vlerës së Bursës arsyeshmerinë e dha asamblisti Ramadani. Le të rishikohet në gjashtë mujorin e dytë me rishikim të buxhetit kjo rritje e bursës siç u propozua.

Kryesuesi e vuri në votim propozimin e DKA-së.

Me shumicë votash u Miratua kërkesa.

Në vazhdim u diskutua Komisioni për ndarjen e bursave . Nga kuvendi do të votohen dy anëtarë, një nga pozita dhe një nga opozita.

U propozuan : 1. Arlinda Selitaj. 2. Kushtrim Haliti. 3. Elbarim Morina. 4. Fatjona Gashi. 5. Të ëplotësohet nga Shoqëria civile

Me shumicë votash u MIRATUA

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit të drejtorisë së Urbanizmit, për iniciimin e procedurave për ndryshimin e hartave zonale të Komunës së Klinës.

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizmit: Përshëndetje të gjithëve. Ne ju kemi referuar kuvendit me një pikë të rendit të ditës për ndryshimin e hartave zonale. Ne kemi shënuar në material edhe në çfarë pikash është e nevojshme ndryshimi. Ky është vetëm iniciim e në të ardhmen do të vijë drafti.

Pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim me 25 vota për U MIRATUA iniciimi I procedurave.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Raporti i dëgjimeve publike për draft buxhetin 2024-2026

Kryesuesi Bacaj tha se është pranuar nga drejtorja Draft buxheti si dhe qarkorja buxhetore nga ministria e Financave.

Në këtë pikë të rendit të ditës fjalën e morri z. Zafer Gashi I cili tha se është I kënaqur me interesimi n e qeverisë për investime në këto vite dhe ndarja e buxhetit nëpër komuna . “Besoj që me një profesionalizëm do të krijohet një plan që do të jetë në të mirë të zhvillimit të komunës” tha mes tjerash z. Gashi.

z. Enver Berisha, drejtor I FEZH: Obligimet e tona që I kemi si drejtori bashkë me ekzekutivin, këtë plan e kemi hartuar bazuar edhe në parametrat e më hershme bashkë edhe me bordin e drejtorëve. Ju kisha lutë që ju si asamblist të jeni prezent gjatë këtij procesi të KAB të merrni pjesë dhe kontribuoni. Krejt kjo me qellim që të bëhet një buxhet I duhur dhe të dihet që ai buxhet është ëpr një vit dhe nuk mund të ndryshohet sa herë të duam ne. Pra, ju ftoj që nga 15 qershori të jeni në zonën tuaj dhe të jeni pjesë e debatit.

Me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 7 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje

z. Esat Raci: Kam dy pyetje. 1. Deri ku kanë shkuar kërkesat e qytetarëve të dëmtuar nga vërshimet? 2. Komuna e Klinës nga një indeks që ka dalë “Transparation internacional” ka dalë diku nga fundi-çka ka ndikuar të jetë aq poshtë?

z. Zenun Elezaj, kryetar: Sa I përket vërshimeve, raporti I aprovuar këtu në kuvend ka shkuar në qeveri dhe mesa dij unë është afër vendim marrjes dhe të bëhet kompensimi. Sa I përket transparencës, janë dy prezantime. Në njërën jemi radhitur e 9-ta por ka shumë gabime dhe ne kemi bërë ankesë. Ne jemi në kërkim edhe të 20 poenëve shtesë që do të ndikoj në performancë. Nuk është vetëm ekzekutivi që vlerësohet , ka të bëjë edhe me kuvend.

z. Zafer Gashi: Janë dy tabela dhe nuk është e vërtetë që është e 9-ta komuna por diku e 20-ta. Pikë totale diku 74.28. Ajo që është shqetësuese ka të bëjë me krahasimin e transparencës që ka bërë KDI. Në vitin 2021 ka qenë 78.41% ose 69 pikë ndërsa në vitin 2022 ka ra % në 71.59 ose me pikë 63. Krahasimi janar-qershor 2021-2022. Kam një lutje të një qytetari të Perçevës. Aty janë duke u bërë disa investime rreth trotuarit dhe nuk janë duke shkuar punët sipas projeksioneve. Me kërkesë të qytetarëve kam qenë në Perçevë. Duhet të lëshohet një qarkore dhe të shpjegohet se asnjë person, militant partie nuk mund të prezantohet si kryetar I fshatit dhe të bëjë ndërhyrje. Nuk janë zgjedhur kryetar e fshatit akoma.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Me datë 19. 04. Kam lëshuar vendimin për kompensimin e qytetarit Sokol Gashi. Tek Perçeva, vazhdimisht I përgjigjem kërkesave të qytetarëve. Ne bashkëpunojmë me çdo qytetar dhe kërkesat e tyre I trajtojmë seriozisht. Metrat në atë trase të shtegut nuk kanë me munguar kurrsesi. Kemi pasur shqetësime prandaj kam shkaur tre herë në Përçevë. Aty ku ka dalë pengesë muri rrethues i oborreve që nuk e kemi rrënuar.

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit: Çdo gjë që tha kryetari është e saktë. Projekti I ka paramasat dhe sa I përket cilësisë së punimeve është një komision vlerësues që do ta kontrolloj.

z. Zafer Gashi: Kam pyetje pasi që është edhe komandanti I policisë. Një prind ka ardhur dje bashkë me fëmijën e vet dhe ka kërkuar që të bëjë test droge. Ju lutem që të kontrollohen objektet ku I frekuentojnë fëmijët. Krejt kjo si duket ka pasoja e shëtitjeve të nxënësve në Shqipëri. Shëtitja e

fundit e SHFM “ Fehmi Agani” nuk ka qenë e mirë dhe shumë nga nxënësit kanë frekuentuar disko etj.

Fjalën ja ndërprejnë kryesuesi duke sugjeruar që pika e rendit është pyetje dhe përgjigje duke sugjeruar që të jetë konkret me pyetje nëse ka.

z. Arben Limanaj: kam edhe një pyetje edhe shqetësim për drejtorin e urbanizimit. Sa metra rrugë do të asfaltohen në Cabiq dhe Caravik? Kam marr disa shqetësime nga banorët e këtyre dy fshatrave për selektimin e banorëve- lagjeve. Pse po ndahen familjet , dikujt I shtrohet rruga e dikujt jo?

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit: Nuk mendoj që po bëhen selektime. Ne jemi duke shtruar me asfalt të gjitha rrugët. Mund te jetë ndonjë lagje që nuk përfshihet por kjo s’do të thotë që nuk do të përfshihet në projektin tjetër. Tani nuk e dijë saktë sa metra rrugë do të shtrohen, do ta sjell këtë informacion seancën e ardhshme.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Është shpallë procedura për pjesën e dytë të projektit dhe çdo rrugë në Caravik do të asfaltohet.

Znj. Arta Pantina: Në mbledhjen e komitetit për shërbime publike e kemi diskutuar projektin për ndriçim dhe shteg të biçikletave nga ura e Klinës deri tek qyteti I Klinës. Dëshiroj të dijë se sa është kosto e projektit dhe a ka me vazhduar projekti edhe në pjesën tjetër?

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Kosto është 474 mijë euro është. Ndërsa për pjesën tjetër kemi bërë kërkesë ministrisë që të na ndihmoj. Punimet ajnë në përfundim e sipër, kemi pak vështirësi nga qytetarët veçanërisht nga afaristët.

Znj. Arta Pantina: A mundem me e dit se sa do të zgjerohet rruga në anën tjetër pasi që ndriçimi është vendosë afër rrugës.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Do të zgjerohemi me distancë të njëjtë dhe do të largohemi me një vijë të plotë nga trotuari që të ua pamundësojmë makinave të afrohen afër trotuarit. Mos ta paragjykojmë projektin para se të kryhet.

z. Arben Limanaj: banorëve nuk duhet të ju thuhet se këtë vit nuk jeni në projekt prandaj e kanë shprehë shqetësimin banorët. Më vjen mirë që është gjetur mundësia që të përfshihen të gjitha lagjet.

z. Esat Raci: Tani sa e morra një kërkesë nga një banorë I fshatit Shtaricë- si është gjendja e kanalizimit në këtë fshat dhe a ka defekte ?

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Në fshatin Shtaricë ka pasur dëme të mëdha në kanalizim gjatë vërshimeve. Jemi në fazën e punimit të një projekti që të rregullohen dëmet e krijuara.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Kontrata është firmosur sot. Besoj që nga nesër do të fillohet eliminimi I të gjitha pasojave të vërshimeve në Shtaricë.

Në vazhdim kishte një debat të shkurtër në lidhje se kush ka qenë më shpesh në fshatin Shtaricë, Esati apo drejtori Berisha.

z. Tunë Dedaj: Unë dua ta falënderoj kryetarin për punët që është duke I bërë. Për mua është punë e shkëlqyer trotuarin nga ura deri në hyrje të Klinës. Ndriçimi është shumë I mirë njëri është për qytetarët dhe tjetri për makinat. Po ashtu edhe trotuari në drejtim të Skenderajt është shumë I mirë dhe do të doja që trotuare të tilla të ndërtohen edhe në drejtim të fshatrave Krushevë e vogël si dhe për Jagodë.

z. Esat Raci: Realisht çdo qytetar dhe ne si asamblastë punëve të mira I gëzohemi. Ndriçimi për autkombaja dhe mjetet të rënda është pengesë në rrugën Ura e Drinit- qytet.

z. Zenun Elezaj, kryetar: I kemi parasysh të gjitha këto shqetësime prandaj në anën e djathtë do të zgjerohet rruga për 1.5 metra por ende nuk I kemi të gjitha të dhënat se sa do të jetë sipas kontratës ekzistuese.

z. Tunë Dedaj: Respekt për ty Esat por unë sa e dijë autokombajnat dhe mjetet e rënda qarkullojnë me përcjellje.

Pasi që nuk kishte pyetje të tjera nga anëtarët e kuvendit, kryesuesi z. Valmir Bacaj e shpalli të mbyllur mbledhjen duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesuesi:

Valmir Bacaj



RAPORTI GJASHTËMUJOR PËR VITIN 2023

Nr. No. 052-19299/23
Data: 09.06.2023

Klina

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Në Raportin e Këshillit për Siguri në Bashkësi për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023, mund të konstatojmë se gjithçka ka filluar me kohë, përmes takimeve dhe aktiviteteve është bërë riorganizimi i Planit për takimet e KKSB-së.

Plotësimi i Planit të punës së KKSB-së me tematika të reja për vitin 2023, numri i takimeve, natyra e takimeve të cilat janë kryesisht tema që prekin sigurinë në komunën tonë.

Sipas kërkesave të anëtarëve për Siguri në Bashkësi, kemi bërë zëvendësimin e anëtarëve të larguar me anëtarë të rinj, të propozuar nga institucionet përkatëse, prej ku edhe përfaqësojnë këtë Këshill, duke ndjekur të gjitha procedurat e caktuara me Rregulloren përkatëse për KKSB.

Temat e rendit të ditës janë të nxjerra nga Plani vjetor i punës së KKSB-së, ku përcaktohen objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi.

Takimi i parë u realizua më 27.02.2023, duke kaluar nëpër të gjitha procedurat e nevojshme.

Pos angazhimit për aktivizim, parimi kryesor i KKSB-së ishte që gjatë kësaj periudhe raportuese, kryesisht të përqendrohet në aktivitete për çështje të sigurisë në bashkëpunim me policinë dhe qytetarët, si dhe me forumet, organizatat tjera të sigurisë, KLSP-të, dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

KKSB-ja ka për synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e Komunës së Klinës.

Në takimin e parë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, janë trajtuar këto çështje:

27.02.2023

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Prezantimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2023;
3. Siguria në Komunën e Klinës;
4. Të ndryshme.

Në takimin e dytë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, janë trajtuar këto çështje:

28.04.2023

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në Komunën e Klinës;
3. Ngjitja e vetëdijesimit nga rreziku i përdorimit të narkotikëve dhe dukurive tjera negative;
4. Të ndryshme.

Takimet e KKSB-së, dy takimet e parapara për këtë gjashtëmujor i ka kryesuar nënkryetarja Komunes së Klinës, znj.Marqe Selmanaj, e cila ka propozuar rendin e ditës, si dhe në takimin e parë bëri prezantimin e Planit të KKSB-së.

Pasi prezantojë të gjitha pikat e rendit të ditës u ndal te siguria në komunë si dhe u dha prioritet dhe ftoi në bashkëpunim të vazhdueshëm të gjithë akterët, siç janë: përfaqësuesit e KKSB-së dhe qytetarët e Komunes së Klinës, që të identifikojnë problemet.

Komandanti i policisë ka raportuar në të dy takimet për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Klinës. Bashkëpunimi i policisë me komunën, anëtarët e KKSB-së si dhe bashkëpunimi me qytetarë ka qenë në nivel shumë të lartë.

Përfaqësuesit e institucioneve të ndryshe, bashkësive fetare, pos kërkesave dhe sugjerimeve, kanë qenë falënderues sa i përket sigurisë nga ana e policisë së Kosovës si dhe nga ana e komunës së Klinës, për bashkëpunim dhe zgjidhjen e kërkesave të parashtruara.

Ka pasur diskutime të ndryshme nga të gjithë anëtarët e KKS-së, përfaqësues nga Këshilli i Prindërve dhe OJQ-ve për probleme të ndryshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Klinës.

Në takim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga OSB-ja, KFOR-i, FSK-ja, etj.

Në diskutim, vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKS-së, janë diskutuar, shqyrtuar nga përfaqësues kompetent të organeve komunale.

Rezultatet që janë arritur dhe priten të arrihen nga rekomandimet e KKS-së gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 dhe në vazhdim janë:

-Është kërkuar nga institucionet që të merren më shumë me rregullimin e trotuareve, ndriçimin, në disa pjesë të qytetit janë ndërmarr masa nga drejtoria përkatëse për rregullimin e ndriçimit dhe po vazhdohet me angazhime .

-Kërkesat janë të vazhdueshme për vendosjen e shenjave të komunikacionit aty ku mungojnë, shenjave adekuate.

-Problem i vazhdueshëm është edhe siguria e qytetarëve nga qentë endacakë, trajtimi i tyre edhe këtë problematikë e kemi orientuar në drejtorinë përkatëse dhe po merren masa.

-Siguria në zonat e banuara me minoritete.

-Pas vërshimeve janë paraqitur probleme shtesë me shtratin e lumit, duhet të vazhdohet me rregullimin e shtratit të lumit. Jemi duke punuar që të sanohen këto probleme me drejtorinë përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë mbajtur dy takime të rregullta të KKS-së nga gjashtë të parapara, të gjitha materialet për mbajtjen e takimeve u janë dorëzuar me kohë anëtarëve dhe pjesëmarrësve të cilët kanë qenë të ftuar në takim.

Zv. Kryesuese,

Margje Selmanaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DRAFT - STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM DHE MARRDHËNIE ME PUBLIKUN 2023 – 2026

Mars 2023, Klinë

SHKURTESAT

IT	Teknologji e Informacionit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SWOT	Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	2
2.	SFONDI	3
2.1.	Profili i komunës	4
2.2.	Administrata komunale	5
2.3.	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	6
2.4.	Korniza ligjore	7
3.	GJENDJA AKTUALE ME KOMUNIKIME	8
3.1.	Perceptimet e qytetarëve.....	9
3.2.	Websajti i komunës dhe platformat sociale	10
3.3.	Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje	11
3.4.	Marrëdhëniet me mediat	12
3.5.	Komunikimi i brendshëm.....	13
3.6.	Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë.....	14
3.7.	Promovimi dhe marketingu i Komunës	15
3.8.	Vlerësimi vetanak - Analiza SWOT	16
4.	PARIMET E KOMUNIKIMIT	17
5.	OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT	18
1.	Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komuna	19
2.	Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat.....	20
3.	Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje	21
6.	KANALE E KOMUNIKIMIT	22
7.	AUDIENCAT, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR	23
8.	PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI	24
9.	ROLET DHE PËRGJEGJËSITË	25
	Shtojca 1: Plani vjetor për informim dhe komunikim 2023 – 2026	26

1.HYRJE

Komuna e Klinës viteve të fundit ka krijuar përvoja të vlefshme në aspektin e komunikimeve strategjike nga e kaluara.

Gjatë viteve të pasluftës ka avancuar në mënyrë sistematike në përmirësimin e spektrit ligjor ndërsa kohëve të fundit ka përmirësuar dhe intensifikuar angazhimin e saj për një komunikim sa më të mirë me palët e interesit, e veçanërisht me qytetarët e Klinës. Gjatë përpjekjeve të komunës së Klinës për të komunikuar me qytetarët, ka organizuar fushata informuese, duke përdorur kryesisht mjetet tradicionale të komunikimit, me qëllim të mbajtjes së qytetarëve të informuar mbi zhvillimet në komunë dhe rreth saj. Format më të shpeshta të komunikimit kanë qenë postimet në vendet e dizajnuara për informim, takimet e drejta për drejta në mes të kryetarit të komunës dhe qytetarëve dhe komunikimeve nëpërmjet radios së vetme që eksiton në komunë. Po ashtu, komuna ka organizuar tubime publike të parapara me ligj. Përkundër përpjekjeve në rritje, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje e diskutim të drejtpërdrejtë me komunën edhe pse është në rritje kohëve të fundit falë angazhimit të komunës, kërkon më shumë angazhim për të arritur në nivel të kënaqshëm.

Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026 është zhvilluar mbi aspiratat e komunës për të avancuar me hapa të shpejtë duke përfituar nga avantazhet që ofrojnë zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i shtuar i mediave të reja si kanale të komunikimit. Përmes këtij dokumenti do të kërkohej një reagim proaktiv i audiencave ndaj aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile, hisedarë dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës.

Kjo do të arrihet përmes thellimit të praktikave të komunikimit me audiencat e brendshme dhe të jashtme duke përdorur kanale të përshtatshme dhe efikase të komunikimit. Së këndejmi, Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2026 është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me aktorë të ndryshëm ashtu dhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të komunës.

Pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm, si një komponentë që përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative.

Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2026, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun,

kurse në raste të veçuara do të angazhojë edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.


Aktivitetet e parapara me këtë strategji janë dizajnuar mbi bazën e një analize gjithëpërfshirëse të proceseve dhe mekanizmave të komunikimit dhe efikasitetit të tyre në performancën e komunës në disa elemente kyçe. Mbi bazën e kësaj analize janë identifikuar mundësitë për përmirësim, të cilat janë përkthyer në objektiva, mesazhe dhe kanale të komunikimit dhe mekanizma për marrjen e informatave kthyesë.

2. SFONDI

2.1. Profili i komunës

Komuna e Klinës, e themeluar në vitin 1954, shtrihet në anën perëndimore të Kosovës, përkatësisht në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit, në një hapësirë të pasur me potenciale natyrore dhe me lidhje të mira të qarkullimit. Kufizohet me shtatë komuna - në veri kufizohet me Istogun, në lindje me Skenderajn dhe Drenasin, në jug me Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën, ndërsa në perëndim me Pejën.

Territori i Komunës së Klinës shquhet për pasuri natyrore. Hapësira karakterizohet me pyje dhe tokë kualitative bujqësore, pasuri nëntokësore, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore. Nëpër Klinë kalojnë pesë lumenj: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Klina, Mirusha dhe Lumi i Istogut. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e ujënxënjeve do të mund të ujiteshin deri në 2.000 ha toka bujqësore. Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike janë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë: kultivimit të kulturave bujqësore, perimeve, pemëve si dhe zhvillimin e blegtorisë, shpezëtarisë dhe bletarisë.



Ekonomia e Klinës është e bazuar në veprimtarinë bujqësore dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore. Bujqësia si aktivitet ekonomik është e bazuar në kushtet e mira të tokës bujqësore, pasurisë me rrjedha ujore si dhe të reshurave të cilat në Klinë janë në sasi të volitshme. Në komunën e Klinës 87.7% e tokës është nën 600 m lartësi mbidetare, ndërsa 95% është tokë pjellore. Disa ndërmarrje industriale – bujqësore të periudhës së paraluftës, tani janë në fazën e privatizimit.

Si resurs i veçantë është edhe parku natyror “Mirusha” i cili me vetitë e rralla estetike, paraqet mundësi për zhvillimin e turizmit me ndikim edhe në qytetin e Klinës. Ujëvarat e Mirushës paraqesin një resurs shumë të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në komunën e Klinës. Vlerat e tilla mundësojnë jo vetëm turizmin në nivelin lokal, por edhe më gjerë, atë ndërkombëtar. Identifikimi i zonave të zhvillimit dhe hartimi i planit hapësinor të parkut natyror Mirusha, do të mundësonte hapjen e rrugës për investime në turizëm, e rëndësishme posaçërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të Klinës të cilat merren me turizëm dhe hotelieri.

Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Klinës, ndërsa në pikëpamje të hapësirës, nuk kërkojnë kushte të posaçme të vendosjes. Shumica e aktiviteteve të banorëve është në veprimtaritë shërbyese – hoteliere dhe zejtare e cila në shumicën e rasteve zhvillohet në kuadër të objekteve të banimit përgjatë rrugëve kryesore. Përveç veprimtarive shërbyese, pas luftës së fundit në Klinë janë themeluar edhe ndërmarrje prodhuese për nevojat e ndërtimit, të cilat kanë renome edhe në mbarë Kosovën.

Në përgjithësi, në komunën e Klinës janë 941 persona të punësuar në sektorin publik dhe rreth 2000 të punësuar në atë privat, shumica prej të cilëve në qytetin e Klinës.

Shërbimet administrative kryesore në nivel të komunës janë të përqendruara në Klinë, ku përfshihen shërbimet e Kuvendit Komunal me zyret përkatëse, Qendra për Punë Sociale (në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale), Qendra për Rregjistrim (në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme), Post-Telekomi, si dhe filialat e disa prej bankave komerciale. Përqendrimi i këtyre shërbimeve në qytetin e Klinës, si dhe i shërbimeve tjera - shkollimi dhe shëndtësia me qasje të lehtë, infrastruktura etj. janë faktorë që kanë ndikuar në tendencat për largimin nga zonat rurale.

Në zonat rurale, shërbimet e vetme administrative ofrohen përmes 13 zyrave të bashkësive lokale.

Komuna e Klinës përfshinë një sipërfaqe prej 308.8 kilometra katrorë. Administrohet nga 9 zyra vendore dhe ka 54 vendbanime. Qyteti i Klinës ka pozitë qendrore në kontekst të komunës dhe paraqet një të rëndësishme të qarkullimit.

Përveç Klinës, si qendër komunale, në kuadër të komunës përfshihen edhe këto vendbanime: Berkovë, Binxhë, Bokshiq, Budisalc, Çabiq, Caravik, Deiq, Dobërdol, Dolle, Dollovë, Dranashiq, Drenoc, Dresnik, Dugajevë, Dush, Dush i Vogël, Gjurgjevik i Madh, Gjurgjevik i Vogël, Gllarevë, Grabanicë, Grabc, Gremnik, Jagodë, Jashanicë, Jelloc, Kërrnicë, Klinafc, Këpuz, Krushevë e Madhe, Krushevë e Vogël, Leskoc, Nagllavë, Përçevë, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm, Pograxhë, Qeskovë, Qupevë, Radulloç, Ranoc, Resnik, Rixhevë, Rudicë, Sferkë, Shtupel, Siqevë, Stupë, Ujmirë, Videjë, Volljakë, Zabërgjë, Zajm dhe Zllakuqan.

2.2 Administrata komunale

Administrata komunale në Klinë është e organizuar në 10 drejtori:

1. Drejtoria për Administratë e Përgjithshme,
2. Drejtoria për Arsim,
3. Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik,
4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
5. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
6. Drejtoria për Shërbime Publike Komunale,
7. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
8. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
9. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,
10. Drejtoria e Inspektoratit.

Në kuadër të administratës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: Zyra për Integritet Evropian, Zyra e Burimeve Njerëzore - Personelit, Zyra Ligjore, Zyra për Auditim të Brendshëm, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, Zyra e Prokurimit, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Barazi Gjinore, Zyra për Teknologji Informative.

2.3 Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në administratën komunale të Klinës përbëhet nga dy zyrtare për informim publik, dhe mbështetën nga zyrtari për teknologji të informacionit. Njëra nga zyrtaret e zyrës për informim në kuadër të kabinetit të Kryetarit, ushtron edhe funksionin e zëdhënëses së komunës.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun kujdeset për transparencën e qeverisjes kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të ngjarjeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësive tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun koordinon konceptimin, organizimin dhe zbatimin e fushatave me karakter informues apo të ndërgjegjësimit.

Spektori mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e mediave, koordinon aktivitetet mediale të përfaqësuesve të komunës, ndërmjetëson në caktimin e intervistave të udhëheqësve komunalë për shtypin, monitoron mediat dhe informon kryetarin dhe drejtuesit e tjerë në lidhje me përmbajtjen e tyre.

Më tej, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun mirëmban webfaqen e Komunës, duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe tenderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

2.4. Korniza ligjore

Hartimi i kësaj Strategjie është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e parakushteve për përfaqësim të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L 040 - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Klinës - përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimit me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

Rregullorja për transparencë - përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Klinës dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në proceset e vendimmarrjes në komunë.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215 - garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuar nga institucionet publike.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna – përcakton rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me rastin e zhvillimit të politikave, rregulloreve dhe akteve nënligjore të komunës.

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2015 për Ueb-Faqet e Institucioneve Publike - është dokument që përcakton standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat e tjera që duhet të kenë të gjitha ueb-faqet e institucioneve publike, duke përfshirë edhe ato të komunave.

3. GJENDJA AKTUALE

Komuna e Klinës, viteve të fundit ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të diversifikojë kanalet e komunikimit me audiencat të ndryshme me synimin që të sigurojë një informimin sa më gjithëpërfshirës, nivel të lartë të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe një ndërveprim të intensiv me mediat dhe publikun, hisedarët, partnerët dhe donatorët e komunës.

Ky komunikim përgjithësisht është realizuar përmes komunikatave për media, intervistave, tabelave të shpalljeve, kontakteve dhe vizitave të drejtpërdrejta me qytetarë, takimeve ne organizatat e shoqërisë civile, kontakteve afaristë, investitorë dhe donatorë, si vendorë ashtu edhe të jashtëm.

Pa dyshim, kanalet më të rëndësishme të komunikimit që komuna sot ka në dispozicion janë ueb sajt i komunës dhe llogaria e komunës në Facebook.

3.1 Perceptimet e qytetarëve



Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet komunale në përgjithësi është relativisht e mirë, 55% e qytetarëve janë shprehur shumë të kënaqur dhe 21% e tyre janë mirë të kënaqur me shërbimet komunale. Në po këto nivele duket të jetë edhe kënaqshmëria e qytetarëve kur është fjala për informimin që qeveria komunale ofron në mbulim të aktiviteteve të veta në web faqen zyrtare. Ky sondazh flet për një performancë relativisht të mirë të komunës në raport me informimin mbi procese të shumëta.

3.2 Websajti i komunës dhe platformat sociale

Komuna përgjatë dy viteve të fundit ka bërë shumë përpjekje që të sigurojë publikimin e të gjitha dokumenteve me rëndësi në websajtin e komunës. Komuna ka arritur të krijojë një infrastrukturë të mirë për të gjithë ata që kërkojnë informacione në websajt. Është arritur që kategoritë kryesore, si: Kuvendi, Kryetari, Financat, Investimet, Lajmet, Konsultimet Publike dhe Prokurimi të jenë të pajisura me të gjitha informacionet e mundshme.

Në vitet në vijim, Zyra për Informim në bashkëpunim me drejtoritë komunale do të vazhdojë ta avancojë përmbajtjen e faqes zyrtare në përputhje me kërkesat e kohës.

Përveç websajtit, komuna është e pranishme me llogarinë e saj në Facebook, e cila në vazhdimësi ofron informacione mbi ngjarjet dhe aktivitetet e administratës komunale dhe Kuvendit. Në këtë drejtim, përveç rritjes së numrit të ndjekësve në rrjetet sociale, fokusi i Komunës për vitet në vijim është që përmbajtjen e informacioneve dhe mesazheve t'ia adaptojë natyrës specifike të platformave për komunikim social, në mënyrë që postimet e saj të jenë më tërheqëse për publikun e të gjitha moshave.

3.3 Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Kuvendi Komunës ka miratuar rregulloren mbi transparencën me synimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet më të fundit në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së 04/2018 mbi Transparençën e Komunave. Ky veprim është pasuar me hartimin e Planit të Veprimit për Transparençë në Komunë 2019-2023, si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë.

3.4 Marrëdhëniet me mediat

Zyra për Informim në Komunën e Klinës përbëhet nga dy zyrtare, të cilat asistohen nga Zyra IT. Duke pasur parasysh madhësinë e komunës, mund të thuhet se personeli i angazhuar, në numër edhe në kompetenca profesionale, është i pamjaftueshëm për të administruar me efikasitet punën e informimit dhe marrëdhënieve me publikun dhe mediat.

Aktualisht, në territorin e Komunës së Klinës operon një radio lokale (Radio Alba) dhe kjo në vetvete paraqet një përparësi, sidomos duke pasur parasysh se spektri ekzistues i mediave me frekuenca kombëtare për të përcjellë ngjarjet në nivele lokale është zbehur shumë viteve të fundit.

Një tjetër aspekt pozitiv është ekzistenca e shumë medimeve online (portaleve), të cilat përveçse janë shumë aktive, kanë edhe një numër të konsiderueshëm ndjekësish.

Mediumet online përbëjnë kanale të rëndësishme për transmetimin e njoftimeve, informacioneve, shpalljeve dhe ngjarjeve a veprimtarive të ndryshme që organizohen nga komuna dhe për komunën.

Gjatë viteve në vijim, komuna do të kërkojë që të rrisë nivelin e komunikimeve duke u bazuar mbi praktikatat tashmë të etabluara të komunikimit, profesionalizmin e zyrës për informim si dhe marrëdhënieve të shëndosha me mediat të ndërtuara ndër vite.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përdorimit të shtuar të mediave elektronike, platformat e komunikimit social, produksionit vizual dhe transmetimeve nga vendi i ngjarjes (livestreaming).

3.5 Komunikimi i brendshëm

Komunikimi brenda për brenda administratës komunale është avancuar organikisht përgjatë viteve dhe përbën një shtyllë të fortë që ka mbështetur komunikimin e jashtëm, por edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të përballuar me sukses dinamikat në rritje të qeverisjes lokale.

Pavarësisht nga kjo, ka hapësira për ndërhyrje në mënyrë që të sigurohet një komunikim edhe më efikas në të gjitha drejtimet.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm përmes Strategjisë Komunale për Komunikim dhe Marrëdhënie e me Publikun 2023-2026 është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe porosi e udhëzime nga menaxhmenti dhe eprorët (komunikim nga lart-poshtë), shkëmbime ndër sektoriale (komunikim i tërthortë) dhe organizomini e takimeve të përbashkëta administratë – ekzekutiv që promovon dëgjimin e zërit të secilit (nga poshtë-lart).

3.6 Bashkëpunimi me aktorë dhe faktorë të tjerë

Komuna vazhdon të kultivojë një bashkëpunim të shëndoshë me organizatat e shoqërisë civile. Për këtë arsye janë nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për rritjen e efikasitetit të shërbimeve komunale si dhe për krijimin e hapësirave për monitorimin e performancës së institucioneve komunale.

Organizata joqeveritare lokale e vendore kanë një trajtim të mirë kur është fjala për pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet komunale, hartimin e politikave dhe pasurimin e legjislacionit, apo çështjeve të tjera me interes publik.

Për më tepër, OJQ-të lokale janë të përfshira në organizimin e shumë ngjarjeve publike që kanë për qëllim rritjen e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe bashkëpunimit me organet shtetërore, përfaqësive diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare me synimin e bashkërendimit të veprimeve në funksion të ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme të komunës në sferën e qeverisjes së mirë, mirëqenies së qytetarëve, por edhe në avancimin e infrastrukturës komunale përmes projekteve kapitale.

Komuna edhe në të ardhmen do të vazhdojë të kultivojë marrëdhënie të shëndosha me aktorët e këtij niveli në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e madhe për projektet dhe nismat që tejkalojnë kapacitetet vetanake të komunës.

3.7 Promovimi dhe marketingu i Komunës

Komuna e Klinës ka nevojë që të rrisë ndjeshëm nivelin e promovimit dhe marketingut të aseteve dhe pasurive të trashëgimisë kulturore, historike, turistike apo ekonomike. Komuna duhet të hulumtojë për forma kreative dhe ekonomikisht të përballueshme në promovimin e vlerave të saj, qoftë në formë të printuar apo digjitale.

3.8 SWOT Analiza

Analiza SWOT është kryer me qëllim që të merret një vlerësim vetanak i zyrtarëve të përfshirë në procesin e hartimit të kësaj strategjie të komunikimit duke marrë në konsideratë përparësitë, dobësitë, mundësitë për përmirësim, si dhe rreziqet eventual në raport me komunikimin efikas të administratës komunale. Më poshtë janë paraqitur vlerësimet e përgjithshme.

PËRPARËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Praktikrat pozitive të komunikimit të brendshëm dhe marrëdhënieve me mediat.

DOBËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT

- Mungesa e burimeve njerëzore në ZIMP

- Kapacitetet dhe aftësitë profesionale të ZIMP për të ndërtuar përcjellë mesazhe të qarta dhe koncize.
- Marrëdhëniet profesionale me përfaqësuesit e mediave dhe OJQ-ve
- Interesimi në zbehje i mediave me frekuenca kombëtare për të ndjekur ngjarje të nivelit lokal
- Mosnjohja e duhur e qytetarëve mbi besueshmërinë e lajmeve që plasohen nga mediat online (portalet)

MUNDËSITË PËR RITJE TË EFIKASITETIT

- Shtimi i kapaciteteve njerëzore në ZIMP
- Përdorimi shtuar i teknologjisë në rritjen e efikasitetit në komunikim me audiencat e ndryshme (mediat, grupet profesionale, OJQ-të, institucionet akademike, etj.)

RREZIQET E MUNDSHME

- Mundësitë e kufizuara financiare të komunës për të mbështetur një plan intensiv komunikimi.
- Tendencë në rritje e qytetarëve që informohen përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi.
- Rritja e vazhdueshme pritjeve për shërbime më cilësore

4. PARIMET E KOMUNIKIMIT

Parimet e komunës për informim dhe komunikim do të bazohen në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok. Këto parime mbështeten në elementet e mëposhtme:

Informimi i kohshëm – nënkupton përpjekje të vazhdueshme për informim të kohshëm në lidhje me vendimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

Ndërveprimi – nënkupton ofrimin e mundësisë për qytetarët që të japin komentet, rekomandimet apo vërejtjet e tyre në lidhje me një informatë të cilin e pranojnë nga komuna. Kjo më pastaj i mundëson komunës që të ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me kërkesat e qytetarëve me qëllim të përmirësimit të përmirësimit të performancës së saj.

Përfshirja dhe mos-diskriminimi – Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve, komunitetit të biznesit, komunitetit kulturor, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni.

Transparenca dhe llogaridhënia – Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në praktikat më të mira të transparencës dhe llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës.

Shumëllojshmëria – nënkupton shfrytëzimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetatat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj.

5. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Komuna e Klinës synon që në vitet pasuese të krijojë një mekanizëm të qëndrueshëm të komunikimit të brendshëm, i cili do të shërbente si një bazament solid për të mbështetur komunikimin me aktorë të jashtëm dhe të marrëdhënieve me mediat, në mënyrë që të promovojë me korrektësi aktivitetet dhe të arriturat e veta, të nxisë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, të shtojë dukshmërinë e vet para publikut, qoftë përmes paraqitjeve sistematike në publik ashtu edhe përmes përdorimit të mediave të reja.

Pavarësisht rezultateve mbresëlënëse të evidentuara gjatë viteve të fundit në fushën e informimit, transparencës dhe llogaridhënies, ekzistojnë hapësira për përmirësim të mëtejshëm në vitet në vijim, sidomos në drejtim të përdorimit të shtuar teknologjisë në komunikimet me audiencat e ndryshme, shtimit të burimeve njerëzore brenda Zyrës për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, si dhe në promovimin më të mirë të komunës dhe aseteve zhvillimore.

Përmes planeve vjetore të komunikimit komuna do të synojë që të intensifikojë edhe marrëdhëniet me mediat dhe publikun e gjerë, në mënyrë që të amortizojë tendencat në rritje të qytetarëve që të informohen përmes burimeve dhe medimeve që shquhen për pasaktësi dhe mungesë besimi.

Duke u nisur nga analiza e gjendjes aktuale me komunikimet, Komuna e Klinës ka përcaktuar tre (3) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

- 1. Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale**
- 2. Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me media**
- 3. Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë**

1. Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale

Komunikimi i brendshëm është një komponentë e rëndësishme e institucioneve publike dhe jo vetëm, sidomos të atyre që në përbërjen dhe natyrën e vet janë më komplekse siç është rasti me administratat komunale. Komuna do të ndërmarrë veprimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen rehat dhe kanë besimin e mjaftueshëm për të shprehur mendimet e tyre në funksion të rritjes së rendimentit të punës dhe cilësisë së shërbimeve. Qëllimi parësor i avancimit të komunikimit të brendshëm është që ta bëjë administratën komunale një institucion të aftë për t'i paraprirë ndryshimeve

2. Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me mediat

Stadi zhvillimor në të cilin ndodhet aktualisht komuna e Klinës kërkon një rishikim prioritetesh ashtu që vëmendja në të ardhmen të përqendrohet te paraqitjet e strukturuar mediale, diversifikimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rrisë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Përpara hapjes së llogarive në platformat e tjera sociale, Komuna do të sigurohet që personeli në ZIMP të trajnohet për përdorimin efikas të tyre. Po ashtu, një vëmendje veçantë do t'i kushtohet konsolidimit të marrëdhënieve me mediat, e sidomos atyre lokale, të cilat numerikisht janë të konsiderueshme dhe mund të ofrojnë një ndihmë të madhe në informimin e drejtë dhe të saktë në raport me veprimtarinë e institucioneve komunale.

3. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje

Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete e Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të aplikojë një qasje komunikimi e cila hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Thënë këtë, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizimin efikas të transparencës, dhe do të stimulojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje duke kultivuar një bashkëpunim të avancuar me organizatat lokale të shoqërisë civile. **Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të**

komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit në vendimmarrjen komunale.

6. KANALET E KOMUNIKIMIT

Në dritën e zhvillimeve teknologjike, Komuna e Rahovecit do të angazhohet që komunikimet në vitet pasuese të përqendrohen te mediat e reja, të cilat mundësojnë një efikasitet më të lartë dhe ndërveprim të shtuar me të gjitha audiencat – qofshin të brendshme apo të jashtme. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës brenda përbrenda administratës komunale dhe me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

Emaili - Në një institucion zyrtar, emaili është një kanal i pazëvendësueshëm komunikimi edhe për faktin se përmbajtjet e mesazheve të emailit kanë pothuajse një status të komunikimit zyrtar. Duke pasur parasysh këtë fakt, është shumë me rëndësi që të punësuarit administratën komunale t'i avancojnë njohuritë për përdorimin e duhur dhe efikas të llogarive zyrtare, përtej normave të përcaktuara me rregullore dhe udhëzime administrative. Për këtë arsye, që në vitin e parë të kësaj Strategjie, Komuna do të shpërndajë *Udhëzuesin për përdorimin e duhur dhe efikas të komunikimit me email*.

Intraneti qeveritar - Është një platformë e mirë për vendosjen e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve relevante në një vend të vetëm, mundëson një qarkullim të lirë të informacionit dhe përbën një medium ku të punësuarit mund të shprehin idetë dhe mendimet e tyre.

Aplikacionet qeveritare - janë një mundësi e mirë për komunikim dhe koordinim të brendshëm dhe ndërinstitutional sepse ofrojnë mundësojnë komunikimin përmes pajisjeve që sot secili i punësuar i ka në dispozicion. Në të ardhmen Komuna do të përpiqet që të shtojë përdorimin e aplikacioneve zyrtare të licencuara dhe që janë në pronësi të Qeverisë, si për shembull **Skype for Business** dhe **Microsoft Teams**.

Webfaqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/kline/> mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Faqja zyrtare në internet do të mirëmbahet rregullisht dhe do të shërbejë si një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm i informimit për qytetarët komunës dhe palët tjera të interesuara.

Platformat e komunikimit social – Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna do të kërkojë për forma më efikase të pranisë së vet në platformat sociale. Në momentin aktual, Komuna e Klinës është e pranishme në platformën sociale Facebook. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2022) me qëllim të hapjes së sa më shumë

kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

Mediat – Komuna në vazhdimësi është përpjekur të kultivojë marrëdhënie profesionale me përfaqësuesit e mediave. Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun do të krijojë lista të konsoliduar të mediave me frekuenca lokale dhe kombëtare me qëllim që të pasqyrojë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut. Mediat online (portalet) me mbulim lokal, janë të shumta në numër dhe përbëjnë kanale të rëndësishme të transmetimit të informacioneve dhe mesazheve të komunës.

Paraqitjet publike dhe në media – janë një formë efikase për t'iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Në këtë kuadër do të intensifikohen konferencat për shtyp (të rregullta dhe të rastit), intervistat dhe debatet në media, takime jorformale me përfaqësuesit e mediave, inaugurime dhe promovim e nismave të ndryshme, shkrime autoriale dhe opinione për çështje specifike që ndërliken me qeverisjen lokale, etj.

Publikimet - janë një aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtjesore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe vizualisht më estetike, e për rrjedhojë edhe më të lexueshme nga publiku dhe grupet e interesuara. Po ashtu, si publikimet formale ashtu edhe ato me karakter promovimi dhe marketingu apo ato me karakter informimi e ndërgjegjësimi do të standardizohen në mënyrë që të arrihen standarde të pranueshme të vizibilitetit.

Videot dhe fotografitë - Rëndësia e imazheve (videot dhe fotografitë) në komunikimet digjitale është rritur në mënyrë dramatike që nga dalja në skenë e platformave për komunikim social. Videot dhe fotografitë, edhe si të vetme dhe e pashoqëruar me narracion, ka aftësinë për të kapur vëmendjen e audiencës, duke gjeneruar interesim dhe përfshirje të madhe.

Takime të strukturuar dhe të planifikuara për organizimin dhe udhëheqjen e takimeve publike të natyrave konsultative – takimet dhe debatet publike, takimet konsultative, dëgjimet buxhetore, takimet komunitare për nisma dhe projekte kapitale, etj.

Tabelat e informimit – Komuna do të përkujdeset që në vendet më të frekuentuara të zonave urbane dhe rurale të vendosë tabelat të informimit të qytetarëve, në mënyrë që njoftimet, informacionet dhe mesazhet që duhen përcjellë te qytetarët të jenë të dukshme dhe të disponueshme për sa më shumë të interesuar.

7. AUDIENCA, MESAZHET DHE IMPAKTI I DËSHIRUAR

Përmes kësaj strategjie komuna e Klinës kërkon të vendosë marrëdhënie të shëndosha dhe me interes reciprok me një numër të madh audiencash duke përcjellë mesazhe e duhura te audiencat e caktuara dhe duke respektuar mendimin e tyre në raport me çështjet e përbashkëta të interesit.

Në këtë aspekt, është e rëndësishme që audiencave të caktuara t’ia përcjellim mesazhet e duhura në mënyrë që jo vetëm t’i informojmë për synimet dhe qëndrimet tona, por edhe që të ndikojmë në përmirësimin e mendimit të tyre për punën që bëhet nga komuna dhe eventualisht t’i bëjmë që të flasin pozitivisht dhe të avokojnë për interesat e komunës.

Tabela më vijim, paraqet në formë të detajuar audiencat me të cilat synon të komunikojë komuna në një mënyrë të organizuar dhe të strukturuar përmes mesazheve të qarta dhe që nuk lënë hapësira për dëmtimin e marrëdhënieve reciproke.

AUDIENCA	MESAZHI: Çfarë duam që ata të mendojnë për ne?	IMPAKTI I DËSHIRUAR: Çfarë veprimesh presim nga ta?
Të punësuarit në administratën komunale të Klinës	<ul style="list-style-type: none"> • Administrata komunale bën gjithçka që është e mundur që të jetë një ambient ku të punësuarit mbahen të informuar, dëgjohen dhe mendimet e tyre respektohen; • Administrata komunale është një ambient ku të punësuarit nxiten dhe inkurajohen që gjërat t’i bëjnë më ndryshe dhe më mirë; • Administrata komunale është një ambient ku sukcesi festohet, dhe ku meritoret vlerësohen dhe shpërblehen • Administrata komunale është një ambient ku secilit i jepet mundësia për të zhvilluar kapacitetet profesionale. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të flasin me pozitivitet mbi ambientin e punës në administratën komunale dhe të promovojnë motivimin për të qenë në shërbim të nevojave dhe interesave të qytetarëve. • Të ndjehen të lirshëm që përvojën e tyre ta vënë në funksion të nxitjes së risive dhe mënyrave kreative të ofrimit të shërbimeve. • Të jenë insistues në promovimin e meritokracisë dhe shpërblimit të arritjeve personale përtej pritjeve dhe planeve të paracaktuara. • Të bashkëpunojnë ngushtë me njësinë e personelit të administratës në identifikimin e fushave për ngritje profesionale.

Qytetarët dhe taksapaguesit e të gjitha kategorive

- Komuna e Klinës është e përkushtuar që përmirësojë cilësinë e qeverisjes.
- Shërbimet e komunës janë me kosto të arsyeshme dhe janë në përmirësim çdo ditë.
- Komuna mirëpret pjesëmarrjen dhe kontributin e qytetarëve në vendimmarrje.
- Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe donatorëve.
- Të shprehen pozitivisht për cilësinë e shërbimeve, qeverisjes dhe demokracisë në komunë.
- Të kenë mirëkuptim për efikasitetin dhe koston e shërbimeve që marrin nga komuna.
- Të kenë mirëkuptim për planifikimin e investimeve kapitale dhe rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimor.
- Të kenë një perceptim pozitiv mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike

Mediat

- Udhëheqja komunale është e përkushtuar për të rritur cilësinë e shërbimeve.
- Komuna e Klinës i shpenzon paratë e taksapaguesve në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të komunës.
- Komuna është e hapur ndaj të gjitha interesimeve tuaja.
- Mbështetja juaj është e domosdoshme në luftimin e korrupsionit dhe keqqeverisjes.
- Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të kohshme, saktë, të sinqertë dhe të paanshme.
- Të raportojnë për nismat dhe projektet pozitive të komunës
- Ta konsiderojnë administratën komunale një burim të besueshëm të informacionit.
- Të ofrojnë kontributin e tyre në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së qeverisjes

Organizatave shoqërisë civile dhe organizatave profesionale

- Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve dhe organizatave profesionale
- Komuna do të mbështesë nismat dhe projektet e shoqërisë civile që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së standardeve demokratike në komunë.
- OSHC-të janë një aleat i besueshëm i komunës në avancimin e praktikave të
- Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre
- Të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje dhe të nxisin pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive
- Të mbështesin përpjekjet e komunës për qeverisje gjithëpërfshirëse.

	transparencës në shpenzimin e fondeve publike	<ul style="list-style-type: none"> • Të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve komunale
Komuniteti i biznesit dhe investitorët e mundshëm	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna e Klinës mbështetë krijim e një ambienti miqësor për të bërit biznes. • Politikat tona fiskale janë të favorshme për zhvillimin e biznesit. • Administrata komunale është e përkushtuar që të rrisë nivelin e cilësisë së shërbimeve. • Komuna synon të jetë një vend i mundësive dhe nxitëse e inovacionit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ta konsiderojnë komunën si një partner të besueshëm në zhvillimin e bizneseve të tyre. • Të flasin pozitivisht për nismat dhe përpjekjet e komunës në përmirësimin e ambientit afarist në komunë. • Të kontribuojnë profesionalisht në përmirësimin e politikave dhe strategjive zhvillimore. • Të inkurajojnë investitorët e huaj të investojnë në Klinë.
Institucionet e Kosovës (Qeveria, Kuvendi i Republikës, agjencitë qeveritare, etj)	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e Qeverisë është jashtëzakonisht e rëndësishme për zhvillimin e komunës. • Administrata komunale është shumë e motivuar për të rritur cilësinë e shërbimeve. • Investimet kapitale janë gjithmonë të menduara mirë dhe në përputhje me vizionin zhvillimor të komunës. • Komuna ka nevojë për mbështetjen e qeverisë në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme 	<ul style="list-style-type: none"> • Të mbështesin vizionin tonë për zhvillim të komunës. • Të kenë parasysh specifikat e komunës dhe nevojave për fonde shtesë. • Të mbështesin nismat tona dhe kërkesat për investime kapitale. • Të mbështesin kërkesat tona për zhvillimin profesional të personelit të administratës komunale.
Partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët	<ul style="list-style-type: none"> • Komuna është e përkushtuar të përmirësojë cilësinë e qeverisjes. • Komuna e Klinës i shfrytëzon kontributet e donatorëve në mënyrë të përgjegjshme. • Komuna është një partner i besueshëm që kujdeset për 	<ul style="list-style-type: none"> • Të flasin me pozitivitet mbi partneritetin me komunën. • Të na mbështesin në avokimin për grumbullimin e fondeve për qëllime zhvillimore. • Të mbështesin komunën në rritjen e cilësisë së qeverisjes, zhvillimit dhe demokracisë.

8. PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI

Zbatimi i kësaj strategjie do të mbështetet në planet vjetore të veprimit. (Shih Shtojcën 1 për planin vjetor të veprimit për informim dhe komunikim 2023-3036). Vlerësimi i zbatimit të planit për komunikim dhe informim do të bëhet mbi baza vjetore nga komisioni i formuar i përbashkët (ekzekutiv/legjislativ), i përbërë nga 3 deri 5 anëtarë.

9. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kuvendi i Komunës së Klinës Nxiti dhe promovon zbatimin e kësaj strategjie për komunikim. Bashkëpunon dhe kontribuon në forma të ndryshme për zbatim efikas.

Kryetari i Komunës Nxiti, promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme. Mbështetë zbatimin efikas të kësaj Strategjie.

Komisioni për vlerësim dhe zbatim të kësaj strategjie Mbikëqyrë zbatimin e kësaj Strategjie. Është përgjegjës për vlerësimin periodik (vjetor) të zbatimit të kësaj strategjie.

Drejtorët e drejtorive komunale Nxisin dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetarin e komunës për progresin në zbatimin e saj. Furnizojnë ZIMP me informacione të cilat meritojnë publicitet dhe vëmendje të publikut. Koordinohen me ZIMP dhe me Kabinetin e Kryetarit për paraqitjet e tyre në media dhe publik.

Informojnë personelin e drejtorive me të cilat udhëheqin me zhvillimet që ndërliken me zhvillimet në komunë.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP)

Është përgjegjëse për të mirëmbajtjen e faqes zyrtare të komunës në internet dhe llogarive në platformat sociale.

Është përgjegjëse për informimin e saktë dhe të kohshëm përmes kanaleve të komunikimit në dispozicion të komunës.

Kontribuon në pasurimin e formave të komunikimit dhe mbanë të informuar Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e komunikimit të jashtëm.

Në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit sigurohet për zbatimin e plotë të Planit të Transparencës.

Të punësuarit në administratën komunale

Kontribuojnë në format që zgjedhin ata për të përmirësuar praktikën e komunikimit në administratën komunale.

Bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive me eprorët e tyre në funksion të përmirësimit të komunikimit

Shtojca 1: Plani vjetor për informim dhe komunikim 2023

PLANI VJETOR I VEPRIMIT PËR INFORMIM DHE KOMUNIKIM 2023-2026

OBJEKTIVI 1: AVANCIMI I KOMUNIKIMIT TË BRENDSHËM NË ADMINISTRATËN KOMUNALE (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA (€)
Krijimi i listave të grupuara të kontakteve me audiencat për komunikim të brendshëm	Shefi i kabinetit të kryetarit dhe ZIMP	janar 2023	pa kosto shtesë
Hartimi i Udhëzuesit për komunikim me email	Shefi i kabinetit të kryetarit	janar 2023	pa kosto shtesë

zyrtar me audiencat e brendshme dhe të jashtme	ZIMP		
Azhurnimi i Programit për Trajnime dhe ngritje profesionale	Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e Personelit	shkurt 2023	pa kosto shtesë
Takimi i Përgjithshëm (1) me stafin e administratës	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e personelit	mars 2023	pa kosto shtesë
Anketimi i personelit mbi efikasitetin e komunikimit (sipas pyetësorit të miratuar)	Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP	shtator 2023	pa kosto shtesë
Anketimi i personelit mbi kënaqshmërinë me kushtet në vendin e punës (sipas pyetësorit të miratuar)	Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP	shtator 2023	pa kosto shtesë
Takimi i Përgjithshëm (2) me stafin e administratës	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e personelit	tetor 2023	pa kosto shtesë
Konferenca Vjetore (gjithëditore) me pjesëmarrjen e zyrtarëve me përgjegjësi menaxhuese në komunë	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive	nëntor 2023	pa kosto shtesë
Festa e fundvitit me personelin e administratës dhe mysafirëve të ftuar – shpërblimet për përformuesit më të dalluar	Kryetari i komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive	dhjetor 2022	1500.00 €

AKTIVITETE TË PËRSËRITURA :

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	SHPESHTËSIA
Mbledhje te rregullta të udhëheqësve të sektorëve me personelin që kanë në mbikëqyrje.	Drejtorët e drejtorive	Në baza javore
Mbledhje e rregullta javore të Kryetarit me drejtorët e drejtorive.	Kryetari i Komunës Shefi i Kabinetit	Në baza javore
Mbledhjet e rregullta mujore të Kryetarit apo Nënkyetarit me drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike	Kryetari i Komunës Nënkyetari i Komunës Drejtorët relevantë	Në baza tremujore
Raportet e konsoliduara periodike të administratës komunale	Kryetari komunës Shefi i kabinetit të kryetarit	Në baza mujore
Përdorim i shtuar i intranetit qeveritar dhe aplikacioneve qeveritare për komunikim në distancë dhe punët ekipore (Skype for Business, Microsoft Teams)	Drejtorët e drejtorive Shefat e sektorëve Zyra IT	Në vazhdimësi sipas rrethanave
Takime të përgjithshme me personelin e administratës komunale	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Nënkyetari i komunës Njësia e personelit	Dy herë në vit
Informim i rregullt dhe i strukturuar i të punësuarve mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndërliken me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës.	Kryetari komunës Nënkyetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP	Sa herë që ka zhvillime që ia vlejné të ndahen me të punësuarit (arritje, ngjarje, këshillime, etj.)

Takimet bashkërenduese të kryetarit me kryesuesin e kuvendit dhe KPF-në

Shefi i kabinetit të kryetarit
Njësia e Kuvendit të Komunës

Para secilës seancë dhe sipas nevojës

Kostoja provizore:
1,500.00 EURO

OBJEKTIVI 2: KRIJIMI I MEKANIZMAVE EFIKAS PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME MEDIAT (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA
Trajnim mbi përdorimin efikas të platformave sociale (FB, Insatgram, YouTube) për personelin në ZIMP.	Njësia e personelit ZIMP	shkurt 2023	300.00€
Takim koordinues i formatit ‘Brunch’ me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat – Tema: bashkëpunimi reciprok në transparencën e komunës dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje.	Kryetari i Komunës ZIMP Kryetari i Kuvendit të Komunës	mars 2023	700.00€
Konferenca e Kryetarit të komunës për paraqitjen e Raportit Vjetor 2023.	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive komunale	mars 2023	pa kosto shtesë
Sondazh në webfaqe dhe Facebook mbi preferencat e tyre qytetarëve për projekte madhore publike.	ZIMP Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun	qershor-korrik 2023	pa kosto shtesë
“Dita e Dyerve të Hapura” të Komunës.	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit ZIMP	korrik 2023	pa kosto shtesë

Pritje e fundvitit për përfaqësuesit e organizatave dhe donatorëve që mbështesin komunën.	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive komunale	dhjetor 2022	1,500.00€
--	---	-----------------	------------------

AKTIVITETE TË PËRSËRITURA :

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FREKUENCA
Organizimi i konferencave për shtyp për çështjet dhe ngjarjet me rëndësi në Komunë	Kabineti i Kryetarit ZIMP	Sipas rastit
Komunikata/njoftime për shtyp	Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun ZIMP	Gjatë gjithë kohës
Intervista dhe prononcime	Kryetari i Komunës Drejtorët e drejtorive ZIMP Personat e autorizuar	Gjatë gjithë kohës dhe sipas autorizimeve
Mirëmbajtja e webfaqes komunale dhe llogarive në platformat sociale	ZIMP Zyrtarët për TI Drejtoritë	Gjatë gjithë kohës
Reklama/Shpallje	Kabineti i Kryetarit Njësia e Personelit Drejtorët e drejtorive ZIMP	Sipas rastit dhe nevojës
Publikimi i dokumenteve në websajt në përputhje me dispozitat ligjore	ZIMP	Ne vazhdimësi
Përdorim sistematik i mediave të reja dhe platformave sociale në	ZIMP Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun	Në vazhdimësi

**funksion të informimit,
komunikimit dhe
promovimit të aktiviteteve të
komunës.**

**Monitorimi i rregullt i
mediave**

ZIMP
Zyrtari për Marrëdhënie me
Publikun

Në vazhdimësi

**Kontakte të rregullta me
përfaqësuesit lokal në
diasporë**

Kryetari i Komunës
Nënkryetari i Komunës
Zyra IT

Në vazhdimësi

**Transmetimi i seancave të
Kuvendit të Komunës
nëpërmjet websajtit dhe
kanalit në YouTube**

ZIMP
Zyra IT

Në vazhdimësi

Kostoja provizore:
2.500.00 EURO

OBJEKTIVI 3: RITJJA E TRANSPARENCËS DHE PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE (AKTIVITETE TË VEÇANTA)			
AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA (€)
Krijimi i listave të kategorizuara të kontakteve me audiencat e jashtme.	Shefi i kabinetit të kryetarit ZIMP Zyra IT	janar 2023	Pa kosto shtesë
Transmetimi online i Komitetit për Politikë dhe Financa.	ZIMP Zyra IT Kuvendi Komunal	janar- dhjetor 2023	1,980.00€

Krijimi i data bazës komunale.	Grupi punues për krijimin e data bazës komunale	Janar 2023	Pa kosto shtesë
<p>Ndërhyrjet në infrastrukturën e websajtit komunës për organizimin dhe kategorizim më të mirë të informacioneve që i shërbehen për publikun:</p> <p>Vegëza materiali përcjellës për pikat e rendit të ditës (materiali shtesë), për seancat dhe KPF-ën,</p> <p>Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi: Vegëza për njoftime të takimeve, për procesverbalet e KKSB-ës dhe për Raportet Periodike të KKSB-ës.</p> <p>Publikimi i Raporteve Financiare të kompanive Publike.</p> <p>Publikimi i pronave komunale.</p> <p>Materiali i Seancave të kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa.</p> <p>Publikimi i dokumenteve në formatet WORD, EXEL, PDF dhe DOKUMENTI FINAL I SKANUAR (dokumentet e miratuara).</p>	ZIMP Zyra IT Drejtoritë komunale	janar 2023	Pa kosto shtesë
Prezantim i Procedurave Standarde të Veprimit për publikimin e akteve dhe	ZIMP Zyra IT Drejtoritë komunale	janar 2023	pa kosto shtesë

dokumenteve të komunës në uebsajtin e komunës.			
Vlerësimi i zbatimit të Planit të Transparencës në vitin 2022.	ZIMP Kabineti i Kryetarit	shkurt 2023	pa kosto shtesë
Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me OJQ-të vendore për mbështetje në organizimin e takimeve dhe dëgjimeve publike të Komunës.	Kryetari i Komunës Kryetari i Kuvendit të Komunës ZIMP	maj 2022	Kostoja provizore e zbatimit 2,500.00
Hartimi i Planit për dëgjimet, publike në lidhje me procesin e buxhetit komunal.	ZIMP Kabineti i Kryetarit Kuvendi Drejtoritë komunale	maj 2023	pa kosto shtesë
Organizimi i formave të reja të dëgjimeve publike në përpunje me Doracakun për Standardet Minimale për Organizimin e Konsultimeve Publike	Zyra për Informim Kryetari i Komunës Kryetari i Kuvendit të Komunës	qershor - shtator 2023	pa kosto shtesë
Formimi i grupit profesional¹ për analizën e performancës së komunës sipas raporteve të MAPL dhe organizatave vendore e ndërkombëtare	Nënkryetari i Komunës Koordinatori për performancë	tetor 2023	pa kosto shtesë
Përpilimi i listës së veprimeve për mënjanimin e mangësive të evidentuara nga raportet e performancës.	Grupi profesional Koordinatori për performancë ZIMP	nëntor 2023	pa kosto shtesë

Kostoja preliminare:
4,480.00 EURO

BUXHETI PROVIZOR PËR VITIN 2023

OBJEKTIVAT	KOSTOJA (€)
(1) Avancimi i komunikimit të brendshëm në administratën komunale	1,500.00
(2) Krijimi i mekanizmave efikas për informim dhe marrëdhënie me media	2,500.00
(3) Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë	4,800.00
	GJITHËSEJ 8,800.00€

Zyrtarja për Informim



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 nen pikën 4) të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 7 të Ligjit nr. 04/L - 071, për sistemin e adresave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës "nr. 29/27, dhjetor 2011), me propozimin e komisionit për emërimin dhe riemërimin e rrugëve në Komunën e Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt për vitin 2023 të mbajtur me 28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për

emërtimin e rrugës me emërin e ish senatorit dhe humanistit Willy Kuypers

1. Miratohet propozimi i komisionit për emërtimin e rrugës, me emrin e ish senatorit dhe humanistit Willy Kuypers.
2. Segmenti i rrugës së emërtuar si në pikën 1 të këtij vendimi përshkohet nga kryqezimi i rrugës "Muhamet Haxhaj" deri tek kryqezimi i rrugës "Ali Kelmendi" në Qytetin e Klinës dhe nuk ka qenë i emërtuar me parë.
3. Rruga emërohet në nderim dhe respekt për humanistin Willy Kuypers i cili dha kontribut të veçant për të drejtat e njëriut në Kosovë.
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale
5. Me këtë vendim njoftohën: MAPL, Kryetari i Komunës, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës së Klinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-14824 /23
Klinë me 04.05 /23



Kryesuesi,
Fadil Gashi